

GJYKATA E APELIT
PRISHTINË

Numri i lëndës: PAKR 440/13

Më: 11 gusht 2015

Gjykata Themelore: Prishtinë, P 448/2012

Originali: në gjuhën angleze

Gjykata e Apelit në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Radostin Petrov, si kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues pastaj gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën e Apelit Roman Raab dhe gjyqtares kosovare në Gjykatën e Apelit Tonka Berishaj si anëtarë të kolegjit, të asistuar nga zyrtari ligjor i EULEX-it Alan Vasak, si procesmbajtës

Në lëndën kundër të pandehurve:

L.G., gjithashtu i njohur si Komandant “L.”, shqiptar i Kosovës, emri i babait R., emri i nënës R. me mbiemër të vajzërisë S., i lindur më [] në [], komuna e [], [], me vendbanim në qendër të qytetit në [], në sheshin [], nuk është në paraburgim, me numër të letërnjoftimit [];

N.M., gjithashtu i njohur si “D.”, shqiptar i Kosovës, emri i babait H., emri i nënës S. me mbiemër të vajzërisë H., i lindur më [] in [], komuna e [], [], me vendbanim në [], [], me numër të letërnjoftimit [];

R.M., gjithashtu i njohur si “R.”, shqiptar i Kosovës, emri i babait M., emri i nënës N. me mbiemër të vajzërisë l., i lindur më [] në [], [], me vendbanim në [], me numër të letërnjoftimit [];

Të akuzuar me aktakuzën e ndryshuar të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) Hep. Nr. 65/2002 të datës 30 qershor 2003, të kufizuar në pikën 8 të aktakuzës dhe në ngjarjet që kanë të bëjnë vetëm me kampin në Llapashticë, për këto vepra penale, të ndjekura penalisht *ex officio*:

Krime lufte kundër popullsisë civile, në veçanti, trajtim çnjerëzor, shkaktim i vuajtjeve të mëdha apo cenim i integritetit trupor ose i shëndetit, aplikim i masave të frikësimit, terrorit dhe torturës, në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 44 e datës 8 tetor 1976) (KPRSFJ), lidhur me nenet 22, 24 26 dhe 30 të KPRSFJ-së, për shkak se nga muaji tetor 1998 deri kah fundi i prillit 1999, L.G., N.M. dhe R.M., me përgjegjësi mbikëqyrëse dhe personale, duke vepruar në bashkëpunim me individë të tjerë të paignifikuar dhe në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, kanë urdhëruar dhe kanë marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë të Kosovës të mbajtur në mënyrë të kundërligjshme në qendrën e mbajtjes së të burgosurve në Llapashticë në përpjekje të detyrimit me forcë të këtyre të burgosurve që t'i pranojnë aktet e pabesisë së tyre ndaj UÇK-së;

Të gjykuar në shkallën e parë nga Gjykata Themelore e Prishtinës me aktgjykimin P 448/2012, të datës 7 qershor 2013,

Me të cilin të pandehurit L.G., N.M. dhe R.M. janë shpallur fajtorë për krime lufte kundër popullsisë civile, në veçanti, trajtim çnjerëzor, shkaktim i vuajtjeve të mëdha apo cenim i integritetit trupor ose i shëndetit, aplikim i masave të frikësimit, terrorit dhe torturës, në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 44 e datës 8 tetor 1976) (KPRSFJ), lidhur me nenet 22, 24 26 dhe 30 të KPRSFJ-së, për shkak se nga muaji tetor 1998 deri kah fundi i prillit 1999, L.G., N.M. dhe R.M., me përgjegjësi mbikëqyrëse dhe personale, duke vepruar në bashkëpunim me individë të tjerë të paignifikuar dhe në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, kanë urdhëruar dhe kanë marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e

civilëve shqiptarë të Kosovës të mbajtur në mënyrë të kundërligjshme në qendrën e mbajtjes së të burgosurve në Llapashticë në përpjekje të detyrimit me forcë të këtyre të burgosurve që t'i pranojnë aktet e pabesisë së tyre ndaj UÇK-së;

Dhe me të cilin L.G. është dënuar në bazë të pikës 8 me 5 (pesë) vjet burgim, N.M. është dënuar në bazë të pikës 8 me 3 (tre) vjet burgim ndërsa R.M. është dënuar në bazë të pikës 8 me 4 (katër) vjet burgim. Në përputhje me nenin 48, paragrafin 2 të KPRSFJ-së dhe me nenin 357, paragrafin 5 të LPP-së, janë përcaktuar këto dënime unike: L.G. do ta vuajë dënimin unik në bazë të pikave 5, 8 dhe 14 prej 6 (gjashtë) vjet burgim; N.M. do ta vuajë dënimin unik në bazë të pikave 5 dhe 8 prej 3 (te) vjet burgim; R.M. do ta vuajë dënimin unik në bazë të pikave 5 dhe 8 prej 4 (katër) vjet burgim;

Pas shqyrtimit të ankesave të parashtruara nga mbrojtësit Mexhid Sylja e Bajram Tmava për të pandehurin L.G., mbrojtësi Fazli Balaj për të pandehurin N.M. si dhe mbrojtësi Aziz Rexha për të pandehurin R.M.,

Pas marrjes së parasysh të përgjigjes së PSRK-së,

Pas marrjes parasysh të propozimit të prokurorit të apelit të shtetit,

Pas mbajtjes së seancës publike të Gjykatës së Apelit më 29 korrik 2015,

Pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 30 korrik dhe më 11 gusht 2015,

Duke vendosur në bazë të neneve 370, 371, 372, 376, 377, 378, 379, 380, 381, 382, 384, 387, 388 dhe 390 të Ligjit të Procedurës Penale (LPP),

Merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Hedhet poshtë si e paafatshme ankesa e avokatit mbrojtës Fazli Balaj për të pandehurin N.M. kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P 448/2012 të datës 7 qershor 2013.

II. Pjesërisht pranohet ankesa e avokatëve mbrojtës Mexhid Syla dhe Bajram Tmava për të pandehurin L.G. kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P 448/2012 të datës 7 qershor 2013, lidhur me llogaritjen në vuajtje të dënimit të kohës së kaluar në paraburgim e cila duhet të përfshihet në dispozitiv. Pjesa tjetër e ankesës refuzohet si e pabazë.

III. Pjesërisht pranohet ankesa e avokatit mbrojtës Aziz Rexha për të pandehurin R.M. kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P 448/2012 të datës 7 qershor 2013, lidhur me llogaritjen në vuajtje të dënimit të kohës së kaluar në paraburgim e cila duhet të përfshihet në dispozitiv. Pjesa tjetër e ankesës refuzohet si e pabazë.

IV. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës P 448/2012 i datës 7 qershor 2013 ndryshohet në dispozitiv. Koha e kaluar në paraburgim nga të pandehurit L.G. dhe R.M. do të llogaritet në vuajtje të dënimit si në vijim:

Në bazë të nenit 50 §1 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri L.G. nga data 28 janar 2002 deri më 23 korrik 2005 si dhe nga data 3 tetor 2009 deri më 9 qershor 2010 do të llogaritet në vuajtje të dënimit.

Në bazë të nenit 50 §1 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri R.M. nga data 11 gusht 2002 deri më 23 korrik 2005 do të llogaritet në vuajtje të dënimit.

V. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës P 448/2012 i datës 7 qershor 2013 ndryshohet *ex officio* në pjesën e dispozitivit. Koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri N.M. do të llogaritet në vuajtje të dënimit si në vijim:

Në bazë të nenit 50 §1 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri N.M. nga data 28 janar 2002 deri më 23 korrik 2005 do të llogaritet në vuajtje të dënimit.

VI. Aktgjykimi vërtetohet në pjesën tjetër.

A R S Y E T I M

I. PROCEDURA E DERITANISHME

Aktakuza fillestare kundër të pandehurve L.G., N.M. dhe R.M. është ngritur më 19 nëntor 2002 në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, më vonë ajo është ndryshuar më 4 shkurt dhe më 30 qershor 2003, me pretendimin se disa pika të krimeve të luftës kundër popullsisë civile ishin në kundërshtim me Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (më tutje në tekst ‘KPRSFJ’), nenin 142 sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59. Kolegji tash do ta shqyrtojë pikën 8 të aktakuzës së ndryshuar të datës 30 qershor 2003; L.G. tashmë me aktgjykim të formës së prerë është shpallur fajtor për pikat 5 e 14 ndërsa N.M. e R.M. tashmë me aktgjykim të formës së prerë janë shpallur fajtorë për pikën 5 të aktakuzës së ndryshuar në fjalë.

Gjykimi (fillestar) në shkallë të parë është mbajtur në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, e cila ka marrë aktgjykimin e saj më 16 korrik 2003, duke i hedhur në tërësi disa prej akuzave dhe disa elemente të disa prej tyre dhe duke i shpallur fajtorë të tre të pandehurit për elementet tjera të veprës penale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile, duke i dënuar si në vijim: L.G.N me 10 vjet, N.M.N me 13 vjet si dhe R.M. me 17 vjet burgim.

Pas ankesës së mbrojtjes të parashtruar kundër të gjitha dënimeve si dhe ankesës së prokurorisë, të parashtruar vetëm kundër dënimit të shqiptuar ndaj L.G., Gjykata Supreme e Kosovës në lëndën Ap Kz 139/2004 ka marrë vendimin e datës 21 korrik 2005 me të cilin ajo ‘i ka anuluar

në tërësi' pikat 1, 2, 3 dhe 12, i ka shfajësuar të pandehurit për pikën 11 ndërsa i ka kthyer në rigjykim pikat e tjera të aktakuzës.

Trupi i parë ri-gjykues në vitin 2009 (P526/05) e ka rishqyrtuar lëndën në fjalë, duke i pranuar edhe një herë provat në tërësi lidhur me pikat 5, 9 dhe 14 të aktakuzës së ndryshuar të datës 30 qershor 2003 [SHËNIM: ka qenë e propozuar edhe një aktakuzë tjetër e ndryshuar edhe më tepër, e ngritur më 14 prill 2009, por që ishte refuzuar nga trupi ri-gjykues, prandaj nuk ka nevojë për komente shtesë rreth saj]. Lidhur me pikën 8, trupi i parë ri-gjykues kishte vërtetuar se provat tashmë ishin pranuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme prandaj ishte kufizuar vetëm në rishqyrtimin e dënimit. Gjatë procedurës, prokurori e kishte tërhequr pikën 9 të aktakuzës.

Më 2 tetor 2009, trupi i parë ri-gjykues i kishte dënuar të pandehurit si në vijim:

a. L.G. për krime të luftës kundër popullsisë civile për pikën 5 (me dënim prej 2 vjet burgim), për pikën 8 (me dënim prej 5 vjet burgim) dhe për pikën 14 (me dënim prej 2 vjet burgim) – dënimi unik me 6 vjet burgim.

b. N.M. për krime të luftës kundër popullsisë civile për pikën 5 (me dënim prej 1 vit e 6 muaj burgim) dhe për pikën 8 (me dënim prej 3 vjet burgim) - dënimi unik me 3 vjet burgim.

c. R.M. për krime të luftës kundër popullsisë civile për pikën 5 (me dënim prej 2 vjet burgim) dhe për pikën 8 (4 vjet burgim) - dënimi unik me 4 vjet burgim.

Më datat 15, 16, dhe 18 shkurt 2010, të tre të pandehurit në fjalë i kanë apeluar dënimet e marra. Prokurori nuk e ka apeluar asnjërin dënim.

Më 26 janar 2011 (Ap Kz 89/2010) Gjykata Supreme e ka marrë vendimin me të cilin i ka konfirmuar vendimet e trupit të parë ri-gjykues për pikat 5 dhe 14. Dënimet në fjalë kanë marrë formë të prerë. Gjykata Supreme megjithatë e ka prishur aktgjykimin dënues lidhur me pikën 8 dhe e ka kthyer për rigjykim të dytë në Gjykatën e Qarkut. Baza e një vendimi të tillë ka qenë se trupi i parë ri-gjykues nuk i ka dëgjuar edhe një herë dëshmitarët lidhur me pikën 8 të aktakuzës.

Trupi gjykues fillestar i vitit 2003 e kishte shpallur dënimin për pikën 8 të aktakuzës së ndryshuar të datës 30 qershor 2003 vetëm në raport me ngjarjet në qendrën e mbajtjes në Llapashticë, duke i shfajësuar të pandehurit përkitazi me ngjarjet e pikës që lidhen me pikën me Majac dhe me Potok. Ky vendim është shqyrtuar nga Gjykata Supreme në vendimin e saj të datës 21 korrik 2005 duke konstatuar se provat janë marrë ashtu si duhet dhe në mënyrë ligjore në përputhje me kodin procedural. Megjithatë, përkundër kësaj, Gjykata Supreme e ka kthyer në rigjykim pikën në fjalë përsëri në gjykatën e shkallës së parë për shkak se aktgjykimi fillestar ‘i ka trajtuar pikat e ndryshme të aktakuzës si një krim të vetëm të luftës për secilin të pandehur’. Trupi i parë ri-gjykues lidhur me këtë pikë e ka konsideruar si obligim të vetin në bazë të vendimit të Gjykatës Supreme, që të kufizohet në çështjen e dënimit, porse kjo konsideratë e gjykatës ka të bëjë vetëm me ngjarjet në Llapashticë për arsye se aktgjykimi lirues lidhur me ngjarjet në Majac dhe Potok mbetet vendim i formës së prerë. Si rezultat i një qëndrimi të këtillë, trupi i parë ri-gjykues nuk i ka dëgjuar edhe një herë dëshmitarët, i ka shpallur fajtorë të pandehurit dhe i ka rishqyrtuar dënimet e shqiptuara. Detyrë e trupit të dytë ri-gjykues ka qenë vetëm ta rigjykojë pikën 8, duke e kufizuar vetëm në ngjarjet në Llapashticë dhe t’i rimarrë në pyetje edhe një herë dëshmitarët (varësisht nga marrëveshja midis palëve për leximin e deklaratave të dëshmitarëve në procesverbal apo për urdhërimin e futjes së deklaratave të dëshmitarëve në procesverbal për shkaqe të tilla si vdekja apo pamundësia e gjetjes së tyre). Për më tepër, pasi që prokuroria nuk e kishte apeluar dënimin e shqiptuar, trupi i dytë ri-gjykues ka qenë i kufizuar nga dënimi maksimal i shqiptuar nga trupi i parë ri-gjykues për këtë pikë. Pas ndërmarrjes së kësaj pune, trupi i dytë ri-gjykues pastaj i ka shqyrtuar dënimet unike për secilin të pandehur.

Më 26 shkurt 2013 trupi i dytë ri-gjykues ka mbajtur shqyrtimin paraprak dhe seancat e shqyrtimit gjyqësor të hapura për publikun më 25 mars 2013 dhe ka vazhduar më 26, 27 mars, më 11 prill, më 7, 8, 10 dhe 22 maj, më 4 dhe 7 qershor 2013 si dhe seancën pjesërisht të mbyllur më 11 prill 2013. Këshillimi dhe votimi janë mbajtur më 6 qershor 2013 ndërsa aktgjykimi është shpallur më 7 qershor 2013 në gjykim të hapur.

Aktgjykimi me shkrim i është dërguar të pandehurit L.G. më 24 shtator 2013 si dhe mbrojtësve të tij Mexhid Syla e Bajram Tmava më 24 shtator 2013. I pandehuri, përmes mbrojtësve të tij, e ka apeluar aktgjykimin më 8 tetor 2013.

Aktgjykimi me shkrim i është dërguar të pandehurit N.M. më 28 shtator 2013 ndërsa mbrojtësit të tij Fazli Balaj më 9 tetor 2013. I pandehuri, përmes mbrojtësit të tij, e ka apeluar aktgjykimin më 22 tetor.

Nuk është e qartë nga fletëdërgesa e aktgjykimit kur i është dërguar të pandehurit R.M.. Aktgjykimi me shkrim i është dërguar mbrojtësit Aziz Rexha më 4 tetor 2013. I pandehuri, përmes mbrojtësit të tij, e ka apeluar aktgjykimin më 16 tetor 2013.

Më 12 nëntor 2013 PSRK-ja ka parashtruar përgjigjen në ankesë.

Lënda i është kaluar Gjykatës së Apelit për vendosje të ankesës më 14 nëntor 2013.

Më 29 nëntor 2013, prokurori i apelit i shtetit ka parashtruar propozimin e vet.

Seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit është mbajtur më 29 korrik 2015 në praninë e të pandehurve, mbrojtësve të tyre (Ramë G. për N.M.) dhe të prokurorit të apelit të shtetit Claudio Pala.

Kolegji është këshilluar dhe ka votuar më 30 korrik dhe më 11 gusht 2015.

II. PARASHTRESAT E PALËVE

A. Ankesa e mbrojtësit të të pandehurit L.G.

Mbrojtësit Mexhid Syla e Bajram Tmava më 7 tetor 2013 kanë bërë ankesë në Gjykatën Themelore për të pandehurin L.G. për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale
- Vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike
- Shkeljes së ligjit penal
- Vendimit të gabuar mbi sanksionet penale

Mbrojtja deklaron se marrja në pyetje e dëshmitarëve të mbrojtur apo anonimë gjatë procedurës paraprake ka pasur shkelje të dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë procedurë, pasi që të pandehurit janë marrë në pyetje pa praninë e mbrojtësit, u është bërë shantazh përmes premtimeve të ndryshme dhe në shumë raste nuk janë marrë në pyetje në gjuhën e tyre amtare, por përmes përkthyesve të cilët nuk e flisnin gjuhën shqipe. Kjo në veçanti ka të bëjë me dëshmitarin nr. 7 R.B. dhe dëshmitarin nr. 4 A.A. Për më tepër, provat materiale gjatë procedurës paraprake janë marrë në mënyrë të kundërligjshme. Të pandehurit po ashtu i është mohuar e drejta e garantuar me Kushtetutë dhe me konventat ndërkombëtare për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.

Lidhur me shkeljet e dispozitave të procedurës penale, mbrojtja thekson se aktgjykimi e ka tejkaluar aktakuzën, në kundërshtim me paragrafin 1.9 të nenit 364 të LPP-së. Nëse e analizojmë me kujdes dispozitivin e aktakuzës dhe dispozitivin e aktgjykimit, është e qartë se aktakuza është tejkaluar për shkak të atributit në aktgjykim të të pandehurve me akte të cilat nuk ishin përcaktuar në aktakuzë.

Përveç kësaj, dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe konfuz për shkak të formulimit si në vijim: “me përgjegjësi të eprorit dhe personale, duke vepruar në bashkëpunim me individë të tjerë të pidentifikuar dhe në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, ka urdhëruar dhe ka marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë të Kosovës.”

Mbrojtja më tej thekson se është e papranueshme pas tri shqyrtimesh gjyqësore të mbajtura në shkallën e parë dhe dy shqyrtimesh gjyqësore të mbajtura në shkallën e dytë, individët dhe të pandehurit e tjerë me të cilët kanë bashkëpunuar të mos identifikohen ende.

Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar manipulon me shprehjen e përgjithshme “civilë shqiptarë” të cilët i ishin nënshtruar vuajtjes dhe torturës, për shkak se nuk e specifikon kush kanë qenë këta shqiptarë dhe çfarë shkalle të torturës të njëjti i ishin nënshtruar.

Për më tepër, në arsyetimin e aktgjykimit nuk theksohet asgjë lidhur me përgjegjësinë e eprorit dhe atë personale të të pandehurit L.G. Ka kundërshti madje edhe në procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor, provat e shtjelluara gjatë gjykimeve dhe asaj se çfarë thuhet në arsyetimin e aktgjykimit të apeluar.

Mbrojtja e pohon se pikërisht ditari i të pandehurit L.G., i cili është humbur, është prova kryesore e cila e mbështet mbrojtjen e tij dhe e konfirmon alibinë e tij.

Mbrojtja më tej thekson se dispozitat e kodit të procedurës penale janë shkelur kur Gjykata Themelore i ka vlerësuar provat e tjera, pasi kjo është bërë me kritere të dyfishta duke u fokusuar në fajësimin e të pandehurit.

Sa i përket vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë faktik, mbrojtja pohon se Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar të gjitha provat e administruara gjatë gjykimit në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Provat nuk e konfirmojnë se i pandehurit L.G. ka urdhëruar dhe ka marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë të Kosovës. Përkundrazi, provat e administruara e konfirmojnë që ai nuk ka pasur autoritet komandues dhe nuk kishte të bënte asgjë me personat e burgosur. Provat e konfirmojnë se ai kishte qenë shef i qendrës për informim, ndërsa nuk kishte autoritet komandues sa iu përket mbikëqyrësve të personave të burgosur.

Mbrojtja më tutje e thekson se ekzistojnë mospajtime lidhur me shumë rrethana që lidhen me deklaratat e dëshmitarit R.B. të dhëna gjatë hetimeve dhe me ato të dhëna gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor. Duke i pasur parasysh këto mospajtime, mbrojtja argumenton se dëshmitë e dëshmitarit R.B. nuk kanë vlerë ligjore dhe për këtë arsye dënimi nuk mund të mbështetet në deklaratat e tija.

Mbrojtja më tutje parashton se Gjykata Themelore është dashur ta shpallë të papranueshme dëshminë e dëshmitarit A.A. , të dhënë para gjyqtarit të procedurës paraprake më 18 tetor 2002, pasi që është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitarëve.

Mbrojtja po ashtu konsideron se deklaratat e dëshmitarëve të tjerë “C, P, I, J, H, D, E, G, F dhe M” nuk provojnë asnjë rrethanë konkrete. Mbrojtja e përsërit qëndrimin e saj se Gjykata Themelore është dashur t’i vlerësojë këto deklarata si prova rrethanore për shkak se të gjithë këta dëshmitarë në dëshmitë e tyre kanë deklaruar atë çfarë u kanë thënë personat e tjerë dhe jo atë çfarë e kanë parë apo e kanë dëgjuar vetë. Lidhur me grupin tjetër të dëshmitarëve: V.J., K.H.,

G.Z., N.I., K.K. etj., Gjykata Themelore i ka vlerësuar dëshmitë e tyre në mënyrë të anshme dhe në dëm të të pandehurit L.G..

Sa iu përket shkeljeve të ligjit penal, mbrojtja pohon se ka qenë lajthim juridik i Gjykatës Themelore kur e ka shpallur fajtor të pandehurin L.G.n për veprën penale krime të luftës sipas nenit 142 të KPRSFJ-së, në cilësinë e bashkëkryerësit me të akuzuarit e tjerë, përderisa përgjegjësia penale po ashtu lidhet edhe me nenin 26 të KPRSFJ-së, i cili ka të bëjë me bashkimin kriminal.

Mbrojtja më tutje parashtron se i pandehuri L.G. ka qenë anëtar i UÇK-së, por kjo gjë në asnjë mënyrë nuk nënkupton se i njëjti ka qenë pjesëtar apo themelues i organizatës kriminale apo i ndërmarrjes kriminale, siç përcaktohet me nenin 26 të KPRSFJ-së.

Gjykata Themelore po ashtu i mban të pandehurit përgjegjës si bashkëkryerës, në bazë të nenit 22 të KPRSFJ-së. Megjithatë, pasi që të njëjtit mbahen përgjegjës edhe sipas nenit 26 të KPRSFJ-së, ata nuk mund të mbahen përgjegjës në bazë të nenit 22 të KPRSFJ-së dhe si bashkëkryerës, për shkak se përgjegjësia sipas nenit 26 të KPRSFJ-së e përfshin edhe përgjegjësinë sipas nenit 22 të KPRSFJ-së.

Më tutje, ligji penal është shkelur edhe kur i pandehuri L.G. është shpallur fajtor për tri vepra penale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile, të cilat është dashur të trajtohen si një vepër e vetme penale.

Ligji penal po ashtu është shkelur kur nuk është specifikuar në mënyrë të qartë kalkulimi i paraburgimit të shqiptuar.

Në fund, lidhur me vendimin e sanksioneve penale, mbrojtja pohon se dënimi i shqiptuar as nuk është i drejtë as nuk është i ligjshëm. Në këtë rast konkret, çfarëdo dënimi është i kundërligjshëm dhe se vetëm aktgjykimi lirues do të ishte aktgjykim i drejtë dhe i ligjshëm.

Për të gjitha këto arsye, mbrojtja kërkon nga Gjykata e Apelit që ta ndryshojë aktgjykimin në fjalë dhe ta lirojë L.G.n.

B. Ankesa e mbrojtësit të të pandehurit N.M.

Mbrojtësi Fazli Balaj më 22 tetor 2013 ka bërë ankesë në Gjykatën Themelore në emër të të pandehurit N.M. për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale
- Vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike
- Shkeljes së ligjit penal
- Vendimit mbi sanksionin penal

Lidhur me shkeljet e dispozitave të procedurës penale, mbrojtja parashtrohet se aktgjykimi në fjalë nuk është i kuptueshëm dhe se vepra penale për të cilën i pandehuri N.M. është shpallur fajtor është e paqartë; si pasojë e kësaj aktgjykimi i kundërshtuar prandaj duhet të anulohet.

Sa i përket vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të fakteve, mbrojtja është e mendimit se Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar të gjitha provat e administruara gjatë gjyqimit në një mënyrë të drejtë. Asnjë dëshmitar kurrë nuk e ka përmendur se i pandehuri N.M. ka urdhëruar apo ka marrë pjesë në abuzimin dhe torturimin e civilëve të burgosur.

Lidhur me shkeljet e ligjit penal, mbrojtja pohon se Gjykata Themelore ka gabuar kur e ka shpallur të pandehurin N.M. fajtor për veprën penale me të cilën e kishte ngarkuar.

Në fund, sa i takon vendimin mbi dënimin, mbrojtja pohon se dënimi i shqiptuar nuk është as i drejtë as i ligjshëm.

Për të gjitha këto arsye, mbrojtja kërkon nga Gjykata e Apelit që ta anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë lëndën për rigjykim apo ta ndryshojë aktgjykimin dhe ta lirojë të pandehurin N.M.

C. Ankesa e mbrojtësit të të pandehurit R.M.

Mbrojtësi Aziz Rexha më 16 tetor 2013 ka parashtuar ankesë në Gjykatën Themelore në emër të të pandehurit R.M. për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale

- Vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike
- Shkeljes së ligjit penal
- Vendimit mbi sanksionin penal

Mbrojtja parashtrohet se asnjë prej deklaratave të dëshmitarëve nuk e implikon të pandehurin R.M. në përfshirjen e tij në veprën penale krime të luftës kundër popullsisë civile. Mbrojtja e përsërit se gjykimi kundër të njëjtit ka karakter politik. Mbrojtja pohon se në aktgjykimin e kundërshtuar nuk ka as prova as sqarime lidhur me qëllimin, veprimet apo lëshimet e të pandehurit R.M..

Sa iu përket shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, mbrojtja parashtrohet se aktgjykimi e ka tejkaluar aktakuzën, në kundërshtim me paragrafët 1.9, 1.11 dhe 2 të nenit 364 të LPP-së. Nëse e analizojmë me kujdes dispozitivin e aktakuzës dhe dispozitivin e aktgjykimit, nuk mund të vërtetohet pa dyshime se aktakuza është tejkaluar për shkak se të pandehurit i janë atribuar veprimet të cilat prokurori nuk i kishte përcaktuar në aktakuzë. Për më tepër, dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe konfuz.

Mbrojtja pohon se në aktgjykimin e kundërshtuar, gjykata nuk e ka shtjelluar bashkëkryerjen sipas nenit 22 të KPRSFJ-së, ndihmën sipas nenit 24 të KPRSFJ-së si dhe dispozitat e tjera ligjore të cilat janë përmendur në dispozitiv.

Faktet e prezantuara në arsyetimin e aktgjykimit nuk janë të sakta, ngase i pandehuri nuk e “ka pranuar se ka qenë komandant në rajonin e Llapashticës”. Kjo deklaratë është e pasaktë dhe paragjyquese sepse i pandehuri R.M. ka qenë komandant i tërë Zonës Operative të Llapit (ZOLL) dhe jo vetëm për fshatin Llapashticë. Për më tepër, nuk ekziston madje asnjë fjali e vetme lidhur me veprimet e supozuara fajësuese me të cilat ngarkohet i pandehuri R.M.. I pandehuri R.M. nuk mund të mbahet përgjegjës për gjithçka që ka ndodhur në qendrën e mbajtjes së të burgosurve në Llapashticë, për shkak se ai nuk ka qenë në dijeni dhe as nuk e kanë informuar vartësit e tij se kush, sipas zinxhirit komandues ka pasur autoritetin dhe përgjegjësinë e drejtpërdrejtë. Lidhur me mungesën e arsyetimit për përgjegjësinë komanduese, mbrojtja i referohet praktikës gjyqësore të TPNJ-së.

Sa i përket vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja është e mendimit se Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar të gjitha provat e administruara në gjykim në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në dëm të të pandehurit R.M.. I

pandehur R.M. as nuk ka qenë në dijëni as nuk mundur ta dijë që vartësit e tij kanë mundur të kryenin veprën penale siç theksohet në dispozitiv dhe në arsyetim të aktgjykimit të kundërshtuar. Mbrojtja thekson se aktgjykimi nuk prodhon asnjë provë e cila do të tregonte përtej çdo dyshimi se i pandehuri R.M. ka qenë duke e drejtuar një regjim të kundërligjshëm paraburgimi me rrahje dhe tortura.

Lidhur me shkeljet e ligjit penal, mbrojtja pohon se Gjykata Themelore ka bërë lajthitje juridike kur e ka shpallur të pandehurin R.M. fajtor për veprën penale të krimeve të luftës sipas nenit 142 të KPRSFJ-së në cilësinë e bashkëkryerësit me të akuzuarit e tjerë. Për më tepër, mbrojtja pretendon se është zbatuar në mënyrë jo të drejtë neni 26 i KPRSFJ-së.

Në fund, sa i takon vendimit mbi dënimin, mbrojtja pohon se dënimi i shqiptuar nuk është as i drejtë as i ligjshëm. Në rastin konkret, çfarëdo dënimi është i kundërligjshëm dhe se vendim i drejtë dhe i ligjshëm do të ishte vetëm marrja e aktgjykimit lirues.

Për të gjitha këto arsye, mbrojtja kërkon nga Gjykata e Apelit që ta ndryshojë aktgjykimin dhe ta lirojë të pandehurin R.M..

D. Përgjigjja e PSRK-së

Prokurori special më 12 nëntor 2013 ka parashtruar përgjigjen në ankesat e mbrojtjes dhe ka kërkuar nga Gjykata e Apelit që t'i refuzojë ankesat si të pabaza dhe ta vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

Prokurori special e thekson se asnjë prej ankesave nuk e vërteton ndonjë gabim të atillë në aktgjykim i cili do t'i bënte ankesat të suksesshme. Nuk ekzistojnë arsye për përmbysjen e aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe për kthimin e lëndës në rigjykim. Ai është i mendimit se ankesat nuk japin shembuj që Gjykata Themelore paska gabuar në mënyrën se si e ka zhvilluar shqyrtimin gjyqësor apo si e ka hartuar aktgjykimin e saj, por thjesht që të pandehurit nuk pajtohen me vendimin i cili ia ka dhënë fund mosndëshkimit të të pandehurve për kryerjen e kësaj veprë penale.

E. Propozimi i prokurorisë së apelit

Prokurori i apelit më 29 nëntor 2013 ka bërë propozim duke kërkuar nga Gjykata e Apelit refuzimin e ankesave të parashtuara në emër të të pandehurve L.G. e R.M. si të pabaza dhe refuzimin e ankesës për të pandehurin N.M. sipas nenit 382 të LPP-së, si të paafatshme. Në propozimin e tij të detajuar, prokurori i EULEX-it i shtjellon çështjet e ngritura si shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimin e gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljet e ligjit penal dhe vendimin mbi dënimin. Prokurori i apelit thekson se Gjykata Themelore nuk ka bërë asnjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Ai më tutje pohon se në kundërshtim nga ajo çfarë pretendojnë të pandehurit, Gjykata Themelore e ka vlerësuar drejt gjendjen faktike dhe nuk e ka shkelur ligjin penal siç pohohet në ankesa. Ai është po ashtu i mendimit se vendimi mbi dënimin nuk ka qenë i gabuar siç theksohet në ankesa. Për këtë arsye, ai i propozon Gjykatës së Apelit që t'i refuzojë ankesat në fjalë.

III. TË GJETURAT E KOLEGJIT

A. Ligji i zbatueshëm procedural në lëndën në fjalë

Aktakuza në këtë lëndë është ngritur në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës më 19 nëntor 2002 dhe është ndryshuar më 4 shkurt 2002 dhe më 30 qershor 2003, para hyrjes në fuqi të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës që ka qenë në fuqi nga data 6 prill 2004 deri më 31 dhjetor 2012.

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës ka pasur një dispozitë kalimtare në nenin 550, sipas së cilës të gjitha procedurat penale në të cilat aktakuza është ngritur para hyrjes në fuqi të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës dhe të cilat nuk kanë përfunduar deri më 6 prill 2004, duhej të vazhdoreshin në bazë të dispozitave të ligjit i cili ka qenë i zbatueshëm përpara (Ligji mbi procedurën penale i vitit 1986) deri sa aktgjykimi i marrë në shqyrtimin gjyqësor ta ketë marrë formën e prerë.

Më 1 janar 2013 në Kosovë ka hyrë ligji i ri procedural – Kodi i Procedurës Penale, ligji penal me nr. 04/L-123. Ky kod e i ka shfuqizuar Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës. Kodi i ri zbatohet në të gjitha procedurat penale në vazhdim e sipër të filluara para hyrjes së tij në fuqi, përveç lëndëve në të cilat shqyrtimi gjyqësor ka filluar para datës 1 janar 2013 apo në të cilat lënda është kthyer në rigjykim (shih edhe mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 56/2013 të miratuar në seancën e saj të përgjithshme të datës 23 janar 2013).

Në lëndën në fjalë, ligj i zbatueshëm procedural në bazë të KPP-së së re në fuqi prandaj do të ishte Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, për shkak se gjykimi në këtë lëndë ka filluar para hyrjes në fuqi të KPP-së. Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës përmes nenit 550, siç është theksuar, megjithatë i kthehet Ligjit mbi Procedurën Penale (LPP) i vitit 1986, prandaj në bazë të nenit 550 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, ligj i zbatueshëm procedural në lëndën në fjalë vazhdon të jetë LPP-ja e vitit 1986. Gjykata e Apelit, në përputhje me këtë, i ka zhvilluar procedurat sipas LPP-së.

B. Kompetenca

Në bazë të nenit 117 të LPP-së, kolegji e ka shqyrtuar kompetencën e tij dhe pasi që palët nuk kanë paraqitur kundërshtime formale, kolegji mjaftohet me këtë: në përputhje me Ligjin mbi gjykatat dhe me Ligjin mbi juridiksionin, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë – Ligji nr. 03/L-053 i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273 dhe me Marrëveshjen në mes të shefit të EULEX Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të datës 18 qershor 2014, kolegji konstaton se EULEX-i ka juridiksion në këtë lëndë dhe se kolegji është kompetent për të vendosur rreth lëndës në fjalë dhe atë në përbërje prej një gjyqtari kosovar dhe dy gjyqtarëve të EULEX-it.

C. Pranueshmëria e ankesës

a. Ankesa e parashtruar në emër të të pandehurit N.M.

Kolegji vëren se aktgjykimi i kundërshtuar i është dorëzuar të pandehurit N.M. më 28 shtator 2013. Aktgjykimi i është dorëzuar pastaj edhe mbrojtësit Fazli Balaj më 9 tetor 2013. Ankesa e parashtruar nga mbrojtësi Fazli Balaj për të pandehurin N.M. është e datës 22 tetor 2013, siç mund të shihet edhe nga vetë ankesa.

Në bazë të nenit 359 të Ligjit të Procedurës Penale (LPP), palët mund të ushtrojnë ankesë kundër aktgjykimit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimit të aktgjykimit. Në bazë të nenit 123 të LPP-së, kur vendimi iu dërgohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, afati i përcaktuar për ushtrimin e mjetit juridik do të fillojë ditën kur dokumenti t'i dorëzohet të pandehurit.

Në rastin në fjalë me asgjë nuk tregohet se i pandehuri apo mbrojtësi i tij kanë qenë të parandaluar nga mundësia e ushtrimit efektiv të së drejtës së ankesës brenda afatit kohor. Afati 15 ditësh për ushtrimin e ankesës prandaj ka skaduar më 13 tetor 2013. Ankesa në emër të të pandehurit është parashtruar tek më 22 tetor 2013, prandaj si e tillë ajo është e paafatshme.

Në pajtim me këtë, kolegji i Gjykatës së Apelit konstaton se ankesa e mbrojtësit Fazli Balaj, e parashtruar më 22 tetor 2013 për të pandehurin N.M., është e paafatshme dhe për këtë arsye nuk do të shqyrtohen fare çështjet meritore të lëndës në fjalë.

b. Ankesa e parashtruara për të pandehurin L.G. dhe R.M.

Ankesat e mbrojtësve Mexhid Sylja e Bajram Tmava për të pandehurin L.G. dhe të mbrojtësit Aziz Rexha për të pandehurin R.M. janë të pranueshme. Ankesat në fjalë janë parashtruar brenda afatit 15 ditësh në përputhje me nenin 359 të LPP-së. Ankesat janë parashtruar nga personat e autorizuar dhe i përmbajnë të gjitha informatat e përcaktuara me nenin 360 dhe 362 të LPP-së.

D. Vërtetimi i gjendjes faktike

Mbrojtja parashtron se Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar drejt dhe në tërësi të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Para vlerësimit të çështjeve meritore të argumenteve të prezantuara nga mbrojtja lidhur me vërtetimin gjoja të gabueshëm ose jo të plotë faktik, kolegji e përsërit standardin e shqyrtimit lidhur me të gjeturat faktike të trupit gjykues.

Është e qartë nga neni 366 i LPP-së se nuk mjafton që ankuesi të demonstrojë vetëm një gabim të pohuar faktik apo vërtetim jo të plotë faktik nga ana e trupit gjykues. Në vend të kësaj, ashtu siç kërkohet me kodin e procedurës penale që vërtetimi i gabueshëm apo jo i plotë i gjendjes faktike të bëjë me një “fakt material”, ankuesi duhet patjetër ta vërtetojë që vërtetimi i gabueshëm apo jo i plotë i gjendjes faktike vërtet ka të bëjë me një fakt material, d.m.th. është i rëndësishëm jetike për marrjen e aktgjykimit.¹ Për më tepër, është parim i përgjithshëm i procedurës së apelit që Gjykata e Apelit duhet patjetër t'i respektojë në një masë të gjeturat faktike të konstatuara nga trupi gjykues për shkak se pikërisht trupi gjykues është në pozitën më të mirë për vlerësimin e provave. Gjykata Supreme shpesh ka theksuar se ajo duhet patjetër *“të lëshojë pe para vlerësimit të trupit gjykues të dëshmitarëve të gjykimit të cilët janë paraqitur dhe kanë dëshmuar personalisht para tyre. Nuk është e drejtë për Gjykatën Supreme të Kosovës që të kalojë mbi vlerësimin e trupit gjykues të besueshmërisë së atyre dëshmitarëve në qoftë se nuk një bazë të fortë për të vepruar kështu.”* Standardi të cilin e ka zbatuar Gjykata Supreme ka qenë që *“të mos ndryshohen të gjeturat e trupit gjykues vetëm në qoftë se provat në të cilat është mbështetur trupi gjykues ka qenë e pamundur të pranohen nga një tribunal i arsyeshëm faktik, apo në rastet kur vlerësimi i tij ka qenë tërësisht i gabuar”* (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, par. 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, par. 30).

Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar në mënyrë të detajuar i ka analizuar provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kolegji e ka shqyrtuar analizën e tërësishme të deklaratave të dëshmitarit, e cila përmendet në par. 34 deri në 101 të aktgjykimit të kundërshtuar (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze). Sipas pikëpamjes së kolegjit, Gjykata Themelore vjen deri tek konstatimet logjike gjatë vlerësimit të asaj prove dhe nuk gjen asnjë kontradiktë në qëndrimin e Gjykatës Themelore. Për më tepër, kolegji në mënyrë autonome i ka shqyrtuar të gjitha provat. Pas këtij vlerësimi të kujdesshëm, kolegji ende është plotësisht i

¹ Shih edhe B. Petric, in: komentimet e neneve të Ligjit të Procedurës Penale të Jugosllavisë, botimi i dytë i vitit 1986, neni 366, para. I. 3.

bindur nga konkluzionet dhe arsyetimi i Gjykatës Themelore. Kolegji konstaton se ka prova të mjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit janë fajtorë për krime të luftës kundër popullsisë civile, në veçanti, për trajtim çnjerëzor, shkaktim të vuajtjeve të mëdha ose shkelje të integritetit trupor apo shëndetit, aplikim të masave të frikësimit dhe terrorit si dhe torturë, në kundërshtim me nenin 142 të KPRSFJ-së, në kuptim të neneve 22, 24, 26 dhe 30 të KPRSFJ-së, sepse nga tetori 1998 deri kah fundi i prillit 1999, L.G., N.M. dhe R.M., me përgjegjësi mbikëqyrëse dhe personale, duke vepruar në bashkëpunim me individë të paidentifikuar dhe në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale – sa i përket ndërmarrjes së përbashkët kriminale e cila tashmë ishte vërtetuar nga Gjykata Supreme (aktgjykimi Ap.-Kz. Nr. 89/2010, më 26 janar 2011) lidhur me pikën 5 - kanë urdhëruar dhe kanë marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë kosovarë të mbajtur në mënyrë të kundërligjshme në qendrën e mbajtjes së të burgosurve në Llapashticë në përpjekje që t'i detyrojnë me forcë ata të burgosur për të pranuar se kanë bërë vepra të tradhtisë ndaj UÇK-së.

Kolegji prandaj nuk e sheh të nevojshme që ta përsërisë analizën e plotë të detajuar të Gjykatës Themelore. Kolegji megjithatë do t'i shtjellojë gjërat në vazhdim.

a. Pranueshmëria e deklaratave të dëshmitarëve

Mbrojtja pretendon se gjatë marrjes në pyetje të disa prej dëshmitarëve të mbrojtur dhe anonimë gjatë fazës paraprake janë shkelur dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë procedurë. Gjykata Themelore në paragrafët 5 deri në 8 të aktgjykimit të kundërshtuar (renditja e faqeve sipas versionit në anglisht) në mënyrë të detajuar e shtjellon çështjen e pranueshmërisë së deklaratave të dëshmitarit dhe po ashtu iu referohet edhe vendimeve të mëhershme të marra nga Gjykata Themelore para marrjes së aktgjykimit. Ashtu siç janë pajtuar të gjitha palët, dëshmitë me shkrim të dëshmitarëve H, J, D, E, G, F, V.J., M, F.M., K.H., G.Z., K.K. dhe N.I. janë pranuar si prova nga ana e Gjykatës Themelore. Gjykata Themelore më tutje ka konstatuar se deklaratat e para në polici të dëshmitarëve R.B., C, D, E, F, G, H dhe P nuk do të përdoren si prova. Sa iu përket deklaratave me shkrim para gjyqtarit hetues, Gjykata Themelore ka vendosur që deklarata R.B.t para gjyqtarit hetues e datës 23 gusht 2002 është e pranueshme, që deklarata e A.A. t para gjyqtarit hetues e datës 14 maj 2002 është e pranueshme dhe se deklarata e A.A. t para gjyqtarit hetues e datës 18 tetor 2002 është e pranueshme. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të deklaratave të

dëshmitarëve dhe të procedurës, kolegji pajtohet plotësisht me vlerësimin e Gjykatës Themelore dhe i vërteton vendimet në fjalë. Sa i takon deklaratën së R.B.t, kolegji në mënyrë specifike e përsërit vendimin e Gjykatës Themelore të marrë me gojë më 4 prill 2013, që ajo çfarë kishte ndodhur gjatë intervistës duket të ketë qenë deklaratë e lirë vullnetare e dëshmitarit mbi atë se çfarë kishte ndodhur në Llapashticë dhe se gjyqtari i procedurës paraprahe nuk kishte bërë asnjë shkelje.² Lidhur me deklaratën e A.A. t, kolegji pajtohet me vendimin e Gjykatës Themelore për ta përjashtuar deklaratën e dhënë më 14 maj 2002 pasi që mbrojtësi nuk ishte i pranishëm. Kolegji më tutje pajtohet me vendimin e Gjykatës Themelore se nuk ka arsye megjithatë për ta përjashtuar deklaratën e dhënë më 18 tetor 2002, pasi që dëshmitari në fjalë ishte dëgjuar në praninë e mbrojtjes.

b. Kredibiliteti dhe besueshmëria e dëshmitarëve

Mbrojtja e konteston kredibilitetin dhe besueshmërinë e deklaratave fajësuese të dëshmitarëve, në veçanti të dëshmitarëve R.B. dhe A.A. . Ankesa e mbrojtjes i shtjellon mospërputhjet dhe kontradiktat në deklaratat e dëshmitarëve, kryesisht lidhur me provat e dhëna nga dëshmitari për mbajtjen me forcë në qendrën e mbajtjes së të burgosurve në Llapashticë dhe për rrahjet e të mbajturve.

Si një vërejtje e përgjithshme lidhur me deklaratat e dëshmitarëve, kolegji vëren se janë të njohura mirë vështirësitë që lidhen me provat identifikuese të cilat duhet t'i vlerësojë me kujdes, para se t'i pranojë si bazë për mbështetjen e dënimit.³ Duke e pasur këtë parasysh, kolegji ka analizuar me kujdes deklaratat e dëshmitarëve në këtë procedurë penale së bashku me arsyetimin e Gjykatës Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar. Kolegji më tutje i ka shqyrtuar me kujdes argumentet e prezantuara në ankesa, përgjigjet dhe propozimin e prokurorit të apelit.

² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 4 prill 2013, faqe 7-8.

³ *Prokuroria kundër Kupreskic et al. (Aktgjykimi i apelit)*, IT-95-16-A, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), 23 tetor 2001, paragrafët 34-41. *Prokuroria v. Clément Kayishema dhe Obed Ruzindana (Aktgjykimi pas gjykimit)*, ICTR-95-1-T, Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandë (TPNR), 21 maj 1999, paragrafët 71-72. *Prokuroria v. Haradinaj et al. (Aktgjykimi pas gjykimit)*, IT-04-84-T, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), 3 prill 2008, paragrafi 29.

Edhe pse Gjykata Themelore nuk i lidhur në mënyrë eksplicite provat fajësuese, deklaratat e R.B.t dhe A.A. t me provat e tjera specifike, deklaratat në fjalë gjejnë mbështetje të mjaftueshme në provat e prezantuara nga Gjykata Themelore në arsyetimin e saj në paragrafët 34 deri 101 të aktgjykimit të kundërshtuar (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze).

Dëshmia e dëshmitarit nr. 7 R.B.

R.B. deklaron se është mbajtur në qendrën e mbajtjes së të burgosurve në Llapashticë dhe gjatë marrjes së tij të dytë në pyetje (kah fundi i nëntorit/ fillimi i dhjetorit 1998) kanë qenë N.M. e L.G. ata që e kishin marrë në pyetje; L. e kishte marrë në pyetje ndërsa N. e kishte rrahur.⁴ R.B.më tutje deklaron se ishte liruar më 31 dhjetor 1998. Dy ditë para kësaj ai ishte marrë në pyetje për herën e tretë. Marrjen e tij në pyetje e kryen L. dhe N.M.. Ai po ashtu ishte rrahur. Të burgosurit H.H., I.S., A.T.M., N.H., M., A.X. dhe dy vëllezër. B. e konfirmon se edhe këta të burgosur ishin rrahur. Të burgosurit rriheshin nganjëherë edhe brenda ahurit dhe atë nga ushtarë të tjerë të UÇK-së, ndërsa nganjëherë detyroheshin ta rrihnin njëri tjetrin.⁵

Gjatë rigjykimit të dytë në vitin 2013, R.B. e kishte mohuar se kishte pasur rrahje në Llapashticë, siç e kishte mohuar edhe gjatë gjykimeve më 2003 dhe më 2009. Gjykata e Apelit është e mendimit se Gjykata Themelore me të drejtë i ka vlerësuar dëshmitë e ndryshme dhe kontradiktore të R.B.t. Ashtu sikur Gjykata Themelore edhe Gjykata e Apelit konstaton se deklaratat e R.B.t të dhëna gjatë shqyrtimeve gjyqësore më 2003, 2009 dhe 2013, në të cilat ai kishte mohuar të kishte pasur ndonjë trajtim të padrejtë, rrahje apo torturim në qendrën për mbajtjen e të burgosurve në Llapashticë, janë ashiqare deklarata të pavërteta. Provat të cilat R.B.i kishte dhënë në deklaratën e tij të parë vërtetohen edhe me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë të cilat kolegji i pranon si të vërteta. Dëshmitarët në fjalë janë këta:

Dëshmitari I (vëllai i A.M.) – A.M. (T.) i kishte treguar Dëshmitarit I lidhur me mbajtjen e tij në Llapashticë. A.M. (T.) ishte torturuar dhe të gjithë ishin keqtrajtuar si nga aspekti emocional

⁴ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 23 gusht 2002, faqe 7, 8 dhe 9.

⁵ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 23 gusht 2002, faqe 17 dhe 19.
faqe 21 nga 34

ashtu dhe ai fizik. A. kishte vrage dhe mavijosje në gjoks dhe në shpinë. A. kishte thënë se ishte rrahur nga L.G..⁶

Dëshmitari J (motra e A.M.t) – A. i kishte treguar Dëshmitarit J që ai dhe të pandehurit e tjerë ishin keqtrajtuar nga L.G. dhe A. ia kishte treguar vrage e veta familjes.⁷

Dëshmitari P – vëllai i I.S. – Në letrën e I. shkruante se L.G. është duke e keqtrajtuar dhe abuzuar me të.⁸

Dëshmia e dëshmitarit 4 A.A.

A.A. deklaroi se ai është mbajtur në qendrën mbajtëse në Llapashticë dhe se menjëherë ishte rrahur prej policisë ushtarake.⁹ Në mesin e të burgosurve të tjerë të pranishëm kanë qenë edhe këta: N.H., H. Nga B., B. nga Prishtina, I.S., A.M., M. nga Kerpimehu, M. nga Dëvrishta dhe M. nga Podujeva.¹⁰ Pas disa ditësh, A. ishte rrahur edhe një herë nga policia ushtarake me shufër dhe me rrymë. A. kishte qenë dëshmitar kur të tjerët merreshin në pyetje dhe i kishte parë dhe i kishte diskutuar me ta lëndimet e pësuar nga rrahja.¹¹ A. ishte liruar rreth datës 23 mars dhe në atë kohë në mesin e të burgosurve kishin qenë edhe V.J., A.K., H.D. dhe të tjerët.¹²

Gjatë rigjykimit të dytë më 2013, A.A. kishte mohuar se kishte pasur ndonjë rrahje në Llapashticë ashtu siç e kishte mohuar edhe gjatë gjykimit në vitin 2003. Gjykata e Apelit është e mendimit se Gjykata e Qarkut me të drejtë i ka vlerësuar dëshmitë e ndryshme dhe kontradiktore të A.A. t. Ashtu sikur Gjykata Themelore edhe Gjykata e Apelit konstaton se deklaratat e A.A. t të dhëna gjatë shqyrtimeve gjyqësore më 2003 dhe 2013, në të cilat ai kishte mohuar të kishte

⁶ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 20 shkurt 2002, faqe 7. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 20 qershor 2003, faqe 5 dhe procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 11 prill 2013, faqe 7-8.

⁷ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 19 shkurt 2002, faqe 7.

⁸ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 7 mars 2002, faqe 4. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 6 maj 2003, faqes 4 dhe 6.

⁹ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 18 tetor 2002, faqe 3.

¹⁰ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 18 tetor 2002, faqe 3-4.

¹¹ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 18 tetor 2002, faqe 5-7 dhe 9-10.

¹² Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 18 tetor 2002, faqe 12-13.

pasur ndonjë trajtim të padrejtë, rrahje apo torturim në qendrën për mbajtjen e të burgosurve në Llapashticë, janë ashiqare deklarata të pavërteta. Provat e dhëna nga A.A. në deklaratën e tij të parë vërtetohen edhe me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, të cilat kolegji i pranon si deklarata të vërteta. Këta dëshmitarë janë:

Dëshmitari D (gruaja e A.K.) – A. i kishte treguar Dëshmitarit D, gjatë një takimi sekret të caktuar nga komandant Y., se mbahej i burgosur në Llapashticë, ku kushtet ishin shumë të këqija dhe se L.G. “po e vriste”. A. kishte qenë i lodhur, i zbehtë dhe kishte shenja mavijosje.¹³

Dëshmitari E (e bija e A.K.) – Y. e kishte caktuar një takim sekret të A.t me familjen e tij. Dëshmitari E e përshkruan gjendjen e babait të saj si shumë të keqe, i tëri i ënjtur, duke u dridhur dhe duart të mbuluara në gjak. Ai qante dhe thoshte “ata po më rrahin, po më mbysin, L. po më rrah dhe po i shtyn të tjerët të më rrahin.”¹⁴

Dëshmitari F (nipi i A.K.) – A. i kishte duart të nxira dhe dukej sikur të kishte qenë i rrahur.¹⁵

Dëshmitari G (e bija e A.K.) – Y. e kishte caktuar një takim sekret të A.t me familjen e vet. Dëshmitari F e përshkruan se A. kishte pasur plagë dhe po qante.¹⁶

Dëshmitari H (i biri i D.B.) – G. e kishte një nishan dallues në faqe. Kur po merrej D. në pyetje, dëshmitari H mundi ta shihte nga dhoma duke e shikuar për dritare. Ai e pa L.G.n duke ia mbajtur armën nënës së tij.¹⁷ Dëshmitari H e pa edhe një të burgosur tjetër në qendrën e mbajtjes, me emrin I.S..¹⁸

Dëshmitari V – Dëshmitari V kishte shkuar në Llapashticë me djalin dhe babanë. Pasi u identifikua para ushtarëve ai u fut në një dhomë me 12 – 13 të burgosur të tjerë dhe u rrah qysh natën e parë. Atij i kujtohet A.A. që ishte i burgosur së bashku me të.¹⁹

¹³ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 12 shkurt 2002, faqe 12-13. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 7 prill 2003, faqet 8-9.

¹⁴ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 12 shkurt 2002, faqe 5-6. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 8 prill 2003, faqet 5-8.

¹⁵ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 13 shkurt 2002, faqe 2-4.

¹⁶ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 14 shkurt 2002, faqe 8 dhe 13. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 8 prill 2003, faqet 15-17.

¹⁷ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 5 shkurt 2002, faqe 10. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 5 maj 2003, faqe 4.

¹⁸ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 5 shkurt 2002, faqe 11.

¹⁹ Deklarata para gjyqtarit hetues e datës 1 mars 2002, faqe 5.

c. Ditari i L.G

Mbrojtja deklaron se mbrojtja e L.G është dëmtuar për shkak të ditarit i cili ishte humbur në një fazë të caktuar diku në mes të gjyqimit të parë në vitin 2003 dhe të rigjyqimit të vitit 2009.

Kolegji pajtohet me përfundimin e sjellë nga Gjykata Themelore se asnjë paragjykim substancial nuk mund t'i shkaktohet L.G.t si pasojë e mungesës së ditarit të tij, siç theksohet në par. 9 të aktgjyqimit të kundërshtuar (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze). Ditari në fjalë thjesht përmban një rrëfim personal të ngjarjeve që ndodhnin dhe nuk paraqet një provë objektive, porse thjesht një burim tjetër të deklaratës së të pandehurit L.G. Për këtë arsye, kolegji njëjtë si Gjykata Themelore konstaton se mungesa e ditarit në fjalë nuk e pengon zhvillimin e gjyqimit të drejtë ndaj të pandehurit L.G.

d. Rolet e të pandehurve

Kolegji konstaton se roli specifik dhe me këtë edhe përgjegjësia e secilit të pandehur është përshkruar në mënyrë specifike në arsyetimin e aktgjyqimit të kundërshtuar të Gjykatës Themelore dhe kolegji e vërteton këtë vlerësim të bërë. Siç specifikohet në paragrafin 102 të aktgjyqimit të kundërshtuar (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze) ka prova të mjaftueshme se i pandehuri L.G. bart edhe përgjegjësi komanduese edhe përgjegjësi të drejtpërdrejtë personale për mbajtjen e kundërligjshme të të burgosurve, për rrahjet dhe torturat e tyre dhe për angazhimin e tij personal gjatë marrjes në pyetje të viktimave përderisa ata rriheshin, pasi që ka qenë shëf i shërbimit të inteligjencës ushtarake për zonën e Llapit dhe në këtë mënyrë i përfshirë në mënyrë qendrore në mbajtjen e qendrës së mbajtjes në paraburgim në Llapashticë.

Sa i përket të pandehurit R.M., në par. 104 të aktgjyqimit të kundërshtuar (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze) specifikohet se i pandehuri R.M. ka qenë komandant zone për zonën e Llapit dhe përgjegjës për mbajtjen e kundërligjshme në paraburgim si dhe organizimin e këtij regjimi, për rrahjet dhe torturat, duke qenë në dijeni të plotë që një sjellje e tij po ndodhte nën autoritetin e tij.

e. Konkluzion

Në konkluzion, kolegji është i bindur se Gjykata Themelore në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se argumentet e ngritura në ankesa nuk i dëmtojnë fare të gjeturat në fjalë. Për këtë arsye, kjo bazë ankimore e mbrojtjes refuzohet si e pabazuar.

E. Konflikti i armatosur

Kolegji pajtohet me arsyetimin e Gjykatës Themelore se në kohën kur është kryer vepra penale në fjalë, nga tetori 1998 deri kah fundi i prillit 1999, në Kosovë, duke e përfshirë këtu edhe qendrën e paraburgimit me vendndodhje në Llapashticë ishte duke u zhvilluar një konflikt i armatosur. Për më tepër, lidhja në mes të sjelljes së të pandehurve me konfliktin e armatosur në fjalë tashmë është vërtetuar në mënyrë të saktë nga Gjykata Themelore, siç është vërtetuar edhe statusi i viktimave. Duke e parë se mbrojtja nuk e ka kontestuar ekzistimin e konfliktit të armatosur, as të elementeve të veprës penale bazë, kolegji përmbahet nga shtjellimi i mëtejshëm i çështjes në fjalë. Kolegji i vërteton të gjeturat e Gjykatës Themelore, të theksuara në paragrafët 24 deri në 27 të aktgjykimit të kundërshtuar (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze).

F. Ndërmarrja e përbashkët kriminale

Mbrojtja thekson se të pandehurit nuk kanë mundur të jenë pjesë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, duke qenë se të njëjtit kanë vepruar për UÇK-në ndërsa UÇK-ja nuk mund të cilësohet si ndërmarrje e përbashkët kriminale.

Siç është theksuar në mënyrë eksplicite në të gjitha vendimet e mëhershme deri më tani, objekt i këtij shqyrtimi janë veprimet e të pandehurve e jo veprimet e UÇK-së si tërësi. UÇK-ja prandaj nuk mund të cilësohet si ndërmarrje e përbashkët kriminale, por si ndërmarrje e përbashkët kriminale do të konsiderohet bashkëpunimi në mes të të pandehurve në fjalë, dhe të kryerësve të tjerë të panjohur, në mes vete. Gjykata Themelore në mënyrë të qartë e ka shtjelluar këtë në paragrafët 105 deri në 108 të aktgjykimit të kundërshtuar (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze) dhe kolegji në tërësi e miraton një vlerësim të tillë.

G. Dispozitivi

a. *Tejkalimi i aktakuzës*

Mbrojtja pohon se është tejkualuar aktakuza pasi që dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar iu atribuon të pandehurve të tilla veprime për të cilat ata nuk ishin akuzuar fare, duke e shkelur kështu nenin 364 §9 të LPP-së, në kuptim të nenit 346 §1 të LPP-së.

Kolegji e vëren se Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar në faqet 1 dhe 2 nuk e përfshin në mënyrë të saktë dhe të plotë formulimin e njëjtë të pikës 8 si në aktakuzë. Megjithatë, kolegji nuk gjen asnjë shkelje lidhur me tejkalimin e aktakuzës në dispozitiv. Dispozitivi përmban dënimin për:

“trajtim çnjerëzor, shkaktim i vuajtjeve të mëdha apo cenim i integritetit trupor ose i shëndetit, aplikim i masave të frikësimit, terrorit dhe torturës ... [...], për shkak se nga tetori 1998 deri kah fundi i prillit 1999, L.G., N.M. dhe R.M., në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, kanë urdhëruar dhe kanë marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë kosovarë të mbajtur në mënyrë të kundërligjshme në qendrën e paraburgimit në Llapashticë [...]”

Edhe pse renditja e frazave dhe e fjalive të dispozitivit dallon nga pika 8 e aktakuzës së ndryshuar Hep. Nr. 65/2002, e datës 30 qershor 2003, veprimet e provuara dhe terminologjia në dispozitiv përputhet saktësisht me aktakuzën:

“nga tetori 1998 deri kah fundi i prillit 1999, L.G., N.M. dhe R.M., duke vepruar në bashkëpunim me individë të tjerë të pidentifikuar dhe në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, kanë urdhëruar dhe kanë marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë kosovarë të mbajtur në mënyrë të kundërligjshme në qendrën e paraburgimit në Llapashticë [...]

Duke e urdhëruar dhe duke marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë kosovarë të mbajtur në mënyrë të kundërligjshme në qendrat e paraburgimit në Llapashticë [...], L.G., N.M. dhe R.M. kanë marrë përgjegjësinë personale dhe atë mbikëqyrëse për krime të luftës, trajtim çnjerëzor, shkaktim i vuajtjeve të mëdha apo cenim i integritetit trupor ose i shëndetit, aplikim i masave të frikësimit, terrorit dhe torturës [...]

Kolegji për këtë arsye konstaton se dispozitivi është në përputhje me nenin 346 §1 të LPP-së, pasi që dispozitivi “lidhet vetëm me veprën penale e cila është objekt i akuzës të cilën e përmban aktakuza e ngritur në fillim apo aktakuza e ndryshuar apo e zgjeruar gjatë shqyrtimit gjyqësor”.

b. Shtjellimi i akteve

Mbrojtja më tutje pohon se aktet si ‘trajtim çnjerëzor, shkaktim i vuajtjeve të mëdha apo cenim i integritetit trupor ose i shëndetit, aplikim i masave të frikësimit, terrorit dhe torturës’ nuk janë shtjelluar në aktgjykimin e kundërshtuar, duke e shkelur kështu nenin 364 §11 të LPP-së.

Kolegji konstaton se edhe pse nuk thuhet në mënyrë eksplicite në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar, në dispozitiv në mënyrë eksplicite thuhet se “trajtim çnjerëzor, shkaktim i vuajtjeve të mëdha apo cenim i integritetit trupor ose i shëndetit, aplikim i masave të frikësimit, terrorit dhe torturës” i referohet urdhërimit dhe pjesëmarrjes në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë kosovarë të mbajtur në paraburgim në mënyrë të kundërligjshme. Kolegji konstaton se

serioziteti i rrahjeve të kombinuara me rrethanat e mbajtjes së viktimave në paraburgim të kundërligjshëm janë mjaftueshëm të rënda për t'u cilësuar si “trajtim çnjerëzor, shkaktim i vuajtjeve të mëdha apo cenim i integritetit trupor ose i shëndetit, aplikim i masave të frikësimit, terrorit dhe torturës”.²⁰ Duke e pasur parasysh faktin se aktgjykimi duhet të lexohet si tërësi, pra si dispozitiv së bashku me arsyetimin, kolegji nuk e konstaton asnjë shkelje të nenit 364 §11 të LPP-së.

c. Identifikimi i bashkëkryerësve

Mbrojtja e thekson se neni 364 §11 i LPP-së është shkelur duke mos i identifikuar individët me të cilët të pandehurit kanë vepruar në bashkëveprim.

Kolegji e vëren se kjo parashtrësë e mbrojtjes tashmë është diskutuar nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj Ap.-Kz. Nr. 89/2009, të datës 26 janar 2011, dhe atë paragrafët 62 deri në 64 (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze). Kolegji pajtohet në tërësi me këtë arsyetim dhe e miraton konkluzionin e Gjykatës Supreme se fakti që emrat e bashkëkryerësve nuk përmenden në dispozitiv nuk e bën të pavlefshëm aktgjykimin e marrë nga Gjykata Themelore.

d. Identifikimi i viktimave

Mbrojtja parashtron se neni 364 §11 i LPP-së është shkelur duke mos i specifikuar identitetet e viktimave në dispozitiv.

Kolegji vëren se parashtrësja në fjalë e mbrojtjes tashmë është diskutuar nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e tyre Ap.-Kz. Nr. 89/2010, të datës 26 janar 2011, dhe atë paragrafët 51 deri në 58 (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze). Kolegji pajtohet plotësisht me arsyetimin dhe e miraton konkluzionin e Gjykatës Supreme se identiteti i viktimave siç janë të dhënat lidhur

²⁰ Aktgjykimi i apelit *Kordić and Čerkez*, para. 106-107; Aktgjykimi i apelit *Blaškić*, para. 143, 155 (rrahja, abuzimi fizik dhe psikologjik si dhe frikësimi mund të përbëjnë persekutimin); Aktgjykimi i apelit *Vasiljević*, para. 143; Aktgjykimi i apelit *Krnjelac*, para. 188. *Shih po ashtu edhe* Aktgjykimi i apelit *Kvočka et al.*, para. 323-325 (ngacmimi, poshtërimi dhe abuzimi psikologjik mund të përbëjnë elemente materiale të krimit të persekutimit).

me emrin, mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes e kështu me radhë kurrë nuk janë kërkuar më parë. Kolegji për këtë arsye nuk gjen asnjë shkelje të nenit 364 §11 të LPP-së.

e. Përgjegjësia mbikëqyrëse

Mbrojtja pohon se përgjegjësia mbikëqyrëse siç përmendet në dispozitiv nuk është arsyetuar mjaftueshëm, duke e shkelur kështu nenin 364 §11 të LPP-së.

Kolegji e vëren se në arsyetimin e aktgjykimit është përshkruar në mënyrë specifike përgjegjësia e secilit të pandehur.

Siç specifikohet në par. 102 (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze) i pandehuri L.G. është shpallur fajtor edhe në bazë të përgjegjësisë së tij komanduese edhe në bazë të përgjegjësisë së drejtpërdrejtë personale për udhëheqjen e mbajtjes së kundërligjshme në paraburgim, rrahjet dhe torturimin e të burgosurve dhe angazhimin personal gjatë marrjes në pyetje të viktimave derisa të njëjtat ishin duke u rrahur, pasi që ka qenë shef i shërbimit ushtarak të inteligjencës për zonën e Llapit dhe kështu ka qenë i përfshirë në mënyrë qendrore në funksionimin e qendrës së mbajtjes në paraburgim në Llapashticë.

Sa i përket të pandehurit R.M., në paragrafin 104 të aktgjykimit të kundërshtuar (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze) specifikohet se i pandehuri R.M. ka qenë komandant i zonës së Llapit dhe përgjegjës dhe drejtues i regjimit të paraburgimit të kundërligjshëm, rrahjeve dhe torturimit dhe plotësisht në dijeni për ndërmarrjen e këtyre veprimeve nën autoritetin e tij.

Konstatimi i roleve komanduese të të pandehurve në fjalë bazohet në radhë të parë në provat e dhëna nga vetë të pandehurit, siç është e detajuar në aktgjykim në paragrafët 29. c-h, 31. a-b dhe 33. a-e (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze). Kolegji në mënyrë specifike konstaton se R.M. kishte deklaruar vetë se L.G. ka qenë shefi i shërbimit të inteligjencës për zonën në fjalë dhe se ka qenë detyrë e tij për t'i zbuluar kërcënimet e mundshme ndaj ushtrisë dhe ndaj popullit.

Për më tepër, kolegji e merr parasysh dhe e miraton vendimin tashmë të sjellë nga Gjykata Supreme në këtë lëndë përmes aktgjykimit Ap.-Kz. Nr. 89/2010, të datës 26 janar 2011, përkatësisht paragrafët 109 deri në 113 (renditja e faqeve sipas versionit në gjuhën angleze), lidhur me kornizën ligjore e cila e rregullon përgjegjësinë mbikëqyrëse (d.m.th. përgjegjësinë komanduese).

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, kolegji konstaton se përgjegjësia mbikëqyrëse e të pandehurve është shtjelluar në mënyrë të mjaftueshme në aktgjykimin e kundërshtuar prandaj e refuzon këtë bazë ankimore.

f. Nenet 22 dhe 26 të KPRSFJ-së

Mbrojtja pretendon se pasi që të pandehurit po mbahen përgjegjës në bazë të nenit 26 të KPRSFJ-së, ata nuk mund të mbahen përgjegjës edhe sipas nenit 22 të KPRSFJ-së si bashkëkryerës, për shkak se përgjegjësia në bazë të nenit 26 të KPRSFJ-së e konsumon përgjegjësinë sipas nenit 22 të KPRSFJ-së.

Kolegji vëren se kjo parashtresë e mbrojtjes tashmë është diskutuar nga ana e Gjykatës Supreme në aktgjykimin e saj **Ap.-Kz. Nr. 89/2010, të datës 26 janar 2011, dhe atë paragrafët 139 dhe 140 (renditja e faqeve në bazë të versionit në anglisht). Kolegji pajtohet plotësisht me këtë arsyetim dhe e miraton konkluzionin e Gjykatës Supreme se nuk mund të konstatohet asnjë shkelje lidhur me shpalljen fajtor të të pandehurve sipas nenit 142 të KPRSFJ-së, lidhur me nenet 22 dhe 26 të KPRSFJ-së.**

g. Koha e kaluar në paraburgim

Kolegji pajtohet me parashtresën e mbrojtjes se Gjykata Themelore nuk e ka përfshirë në dispozitiv se koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në vuajtjen e dënimit. Kolegji prandaj do ta ndryshojë aktgjykimin në përputhje me këtë dhe do ta llogaritë kohën e kaluar në paraburgim në dënim, në përputhje me nenin 50 §1 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Sa i përket të pandehurit L.G., koha të cilën ai e ka kaluar në

paraburgim nga data 28 janar 2002 deri më datën 23 korrik 2005 si dhe nga data 3 tetor 2009 deri më datën 9 qershor 2010, do t'i llogaritet në vuajtje të dënimit. Ndërsa lidhur me të pandehurin R.M., në vuajtje të dënimit do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 11 gusht 2002 deri më datën 23 korrik 2005.

Edhe pse ankesa e të pandehurit N.M. hedhet poshtë si e paafatshme, kolegji megjithatë do ta ndryshojë *ex officio* aktgjykimin edhe në rastin e tij, në përputhje me nenin 380 të LPP-së. Sa i përket të pandehurit N.M., koha e kaluar në paraburgim nga 28 janari 2002 deri më 23 korrik 2005 po ashtu do t'i llogaritet në vuajtje të dënimit.

H. Aktet kriminale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile

Mbrojtja pohon se ligji penal është shkelur për shkak se i pandehuri L.G. është shpallur fajtor për tri vepra penale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile, të cilat është dashur të trajtohen si një vepër penale e vetme.

Kolegji vëren se parashtrësia e mbrojtjes tashmë është diskutuar nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj Ap.-Kz. Nr. 89/2010, të datës 26 janar 2011, pikërisht në paragrafët 76 deri në 82 (sipas renditjes së faqeve në versionin në gjuhën angleze). Kolegji plotësisht pajtohet me këtë arsyetim dhe e miraton konkluzionin e arritur nga Gjykata Supreme që kushtet e përcaktuara për aktet penale të vazhduara nuk ekzistojnë në lëndët e krimeve të luftës kundër popullsisë civile, për shkak se aktet kriminale individuale të cilat mund të përbëjnë krime të luftës në lëndën në fjalë nuk mund të konsiderohen si një bashkim i qartë në mes tyre. Kolegji nuk e gjen asnjë shkelje.

I. Periudha kohore

Mbrojtja e ngre edhe çështjen e periudhës relativisht të gjatë kohore e cila ka kaluar në mes të fillimit të procedurës penale dhe aktgjyimit të sjellë nga ky kolegji. Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj AP.-Kz Nr. 89/2010 të datës 26 janar 2011, e ka adresuar në mënyrë të detajuar pikërisht në paragrafët 148 deri në 153 (sipas renditjes së faqeve në versionin në gjuhën angleze).

Gjykata Supreme ka konstatuar se në këtë lëndë nuk është shkelur neni 6 §1 i Konventës Evropiane mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNj), i cili për secilin gjykim e përfshin nevojë e kohëzgjatjes së arsyeshme të tij. Kolegji e miraton këtë arsyetim në tërësi. Për më tepër, kolegji po ashtu nuk e gjen asnjë bazë për të konstatuar se neni 6 §1 i KEDNj-së është shkelur nga koha kur është marrë aktgjykimi i sipërpërmendur i Gjykatës Supreme e deri në kohën kur Gjykata e Apelit e ka marrë këtë aktgjykim. Vonesa vjen edhe si pasojë e faktit që lënda i ishte ri-caktuar kryetarit të kolegjit / gjyqtarit raportues më 29 shtator 2014 por se i njëjti nuk ka qenë në gjendje ta ushtrojë funksionin e tij gjyqësor deri në fund të marsit 2015, kur edhe ishte emëruar në mënyrë zyrtare nga ana e Presidentes së Kosovës.

J. Vendimi mbi sanksionin penal

Mbrojtja e ka kontestuar vërtetimin e dënimeve duke i konsideruar të njëjtat si të padrejta dhe të kundërligjshme.

Në bazë të nenit 357, par. 8 të LPP-së, Gjykata Themelore pikërisht në paragrafët 105-114 të aktgjykimit të kundërshtuar (sipas renditjes së faqeve në versionin në gjuhën angleze) i ka shqyrtuar të gjithë faktorët relevantë të nevojshëm për caktimin e dënimit adekuat. Kolegji pajtohet plotësisht me këtë analizë të bërë. Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë i ka vlerësuar dhe i ka peshuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese duke ardhur deri tek dënimet proporcionale. Mbrojtja nuk ka sjellë përpara asnjë rrethanë të re e cila tashmë nuk është shqyrtuar nga Gjykata Themelore. Kolegji, për këtë arsye i refuzon parashtrirat e mbrojtjes.

K. Vërejtjet përfundimtare

Gjykata e Apelit – për të gjitha arsyet e shtjelluara më lart – në mënyrë të pjesshme i pranon ankesat e mbrojtjes lidhur me atë që në dispozitiv duhet të jetë e përfshirë pjesa ku thuhet se koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në vuajtje të dënimit, duke e ndryshuar dispozitivin në përputhje me këtë. Bazat tjera ankimore të ankesave refuzohen ndërsa aktgjykimi i kundërshtuar vërtetohet në pjesën tjetër.

Aktgjykimi i arsytuar me shkrim është përfunduar më 7 tetor 2015.

Kryetari i kolegjit

Radostin Petrov
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtarja e kolegjit

Tonka Berishaj
Gjyqtare kosovare

Anëtari i kolegjit

Roman Raab
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës

Alan Vasak
Zyrtar ligjor i EULEX-it

Gjykata e Apelit

Prishtinë

PAKR 440/14

11 gusht 2015